

VENDIM
Nr.359, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.358, DATË 28.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË
DOGANAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.358, datë 28.7.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 “Paga e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe paga e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Doganave”, shfuqizohen.

b) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës së doganave”, zëvendësohet me lidhjen nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të doganave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.2 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave dhe nga fondi limit i planifikuar për shpërblimet në sistemin doganor për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË
DOGANAVE

				PAGA MUJORE			
				Paga individuale (Paga bazë)		Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
KATEGORIA		Paga e grupit (PG)	Pozicioni	Shtesa vjetore për vjetërsi	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	II-a		Drejtor i Përgjithshëm	2%		97 713	13 000
	II-b		Zv/drejtor i Përgjithshëm	2%		80 342	13 000
A	III-a	1	Këshilltar.Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë. Nëpunës ndërlidhës i qendrës SECI	2%		59 714	16 500
B	III-a/1	1	Përgjegjës/Shef sektori. Specialist i marrëdhënieve me publikun. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë-Thanë,Elbasan. Kryehetues doganor. Shef operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës.	2%		49 942	15 000
C1	III-b	1	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. Specialist laboratori. Përkthyes. Inspektor kontrolli. Koordinator në DOH. Shef turni. Komandant grupi antikontrabandë. Doganier analize risku aposteriori, borxhi. Jurist. Administrator rrjeti në degë doganore.	2%		43 428	13 500
C2	IV-a	1	Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Llogaritar. Inspektor antikontrabande. Asistent laboratori.	2%		32 571	13 000
C3	IV-b	2	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretare. Arkivist	2%		21 714	11 000
D1		2	Arkëtar. Magazinionier.Furnitor. Operator. Shofer. Teknik. Shoqërues	2%		15 750	9000
D2		3	Centralist. Sportelist.	2%		12 600	5000

			Sanitar. Mirëmbajtës				
D2		4	Pastrim mirëmbajtje	2%		12 600	3000

Lidhja nr.2

GRUPI	PAGA NË LEKË
1	10 050
2	8 950
3	7 000
4	4 500